
ANALIZË STATISTIKORE E TREGUESVE TË INSPEKTIMIT

JANAR-SHTATOR 2019

PARATHËNIE

Në dokumentin vijues - hartuar në bazë të instrumentave ndërkombëtare lidhur me Inspektimin e Punës e që përfshijnë, konventat e ILO-s, Nr. 81 “Inspektimi i Punës”, Nr. 129 “Inspektimi i Punës në Bujqësi”, Nr. 155 ”Siguria dhe Shëndetit në Punë”, janë përmbledhur rezultatet më domethënëse të veprimtarisë së ISHPSHSH-së e kontrolleve të kryera nga inspektorët e punës gjatë periudhës janar-shtator 2019.

Megjithë numrin e kufizuar të inspektorëve, për shkak të lëvizjeve e vendeve vakante që aktualisht janë 14 pozicione inspektor pune, e që zënë 14.3% të stafit të inspektorëve (total 98 inspektor pune në strukturë) objektivi sasior i inspektimeve që do të kryheshin gjatë këtij 9-mujori është arritur plotësisht.

Rezultatet e inspektimeve të kryera, në një gamë sektorësh të ndryshëm, me plane operacionale, në momente piku të zhvillimit të aktiviteteve, si në sezonin turistik, apo të aktiviteteve ndërtuese prodhuese e minerare, si aktivitete me risk të lartë e shumë të lartë për sigurinë e shëndetin në punë, e fluks të shtuar pune, në këtë periudhë kohore, pati efektivitet strategjia e orientimit të inspektimeve si në rastet e programimit në system ashtu dhe të hapjes së çështjeve për inspektim jashtë programimi e për arsye madhore e në zonat të ndryshme gjeografike të ushtrimit të aktiviteteve në territorit kombëtar.

Planifikimi i inspektimeve (programim apo jashtë programimi) i orientuar në baza analitike, në të vërtetë ka bërë të mundur, efektivitet si në evidentimin, ashtu dhe goditjen e punës së paligjshme e për të shmangur detyrimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, apo shkeljeve të dispozitave ligjore të shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës, në sektorë të ndryshëm.

Rezultatet pozitive të arritura në përgjithësi, janë tregues të procesit të inspektimit online dhe përmirësimeve të vazhdueshme të kësaj platforme, si aksesimi në çështje inspektimi i “e-sig 025”, “e-sig 027” dhe së fundmi mundësisë së hapjes e kryerjes së inspektimeve edhe në subjekte që nuk kanë deklaruar adresën sekondare të ushtrimit të aktivitetit.

Një tjetër arritje e punës është mundësia e daljes në vendimarrje-inspektimi të drejtë e korrekte, pas konsultimit me platformën “matrica e dënimeve”, e cila tashmë ndërthur, legjislacionin e punës, shkeljet e konstatuara në inspektim, kohëzgjatjen e cdo shkeljeje, shkallën e demit për cdo shkelje, punëmarrësit që preken nga shkelja ligjore, historikun e inspektimeve të mëparshme të subjektit, mbi konstatimet e nderhyrjet për korigjimin e shkeljeve të mëparshme të subjektit.

KRYEINSPEKTORI
Arben Seferaj

REZULTATET E PËRGJITHSHME TË KONTROLLEVE INSPEKTUESE NGA ISHPSHSH

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore si një organ i qeverisjes qendrore, si përgjegjës për nivelin e zbatimit e legjislacionit të punës nga të gjithë, punëdhënës e punëmarrës që ushtrojnë veprimatrinë e tyre në Republikën e Shqipërisë, mbështet veprimarinë kontrolluese në dy ligjet bazë të inspektimit, Ligji Nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe Ligji Nr. 9634, datë 30.10.2006 “Për Inspektimin e Punës”.

Gjatë periudhës së 9-mujorit 2019, Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ka kryer gjithsej 10042 inspektime në subjekte Private dhe Shtetërore, e ku rezultojnë 2285 inspektime më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Të dhënat e inspektimeve realizuar në të njëjtat periudha kohore respektive

9 mujore 2018	7757 (inspektime)
9 mujore 2019	10042 (inspektime)

	Private dhe Shtetërore			Vetëm Private		
	Inspektime	Nr i Punëmarrësve	Mesatare e vendeve të punës për subjekt	Inspektime	Nr i Punëmarrësve	Mesatare e vendeve të punës për subjekt
Viti 2016	11299	219114	19.4	11235	210320	18.7
Viti 2017	7958	182154	22.9	7923	176744	22.3
(9-mujore) 2018	7757	208086	26.8	7698	193465	25.1
(9 mujore) 2019	10042	219573	21.9	9994	208596	20.9

Procesi i inspektimit të punës, si pjesë e punës së secilit inspektor në misionin e tij, është sigurimi dhe kontrolli i zbatueshmërisë së dispozitave ligjore kryesisht për:

- ✓ Sigurimin e çdo punëmarrësi informal,
- ✓ Ligjshmërinë në zbatimin e kohëzgjatjes së punës,
- ✓ Pagesën për punë të kryer konform legjislacionit,
- ✓ Higjenën dhe mirëqenien në vendin e punës,
- ✓ Punësimin e ligjshëm të fëmijëve,
- ✓ Si dhe çështje të tjera, që lidhen ngushtë me marrëdhënien e punës, sigurinë në vendin e punës.

Gjatë këtyre muajve janë trajtuar gjithsej 600 ankesa, nga të cilat 426 kanë qënë raste të ndjekura me inspektim-ankese të cilat nga ana sasiore zënë 4% të inspektimeve e kontrolleve të zhvilluara në këtë periudhe.

Orientimi i inspektimeve ka synuar:

- ✓ Minimizimin e punës informale nëpërmjet forcimit të kontrollit, dhe marrjes së masës administrative “pezullim” për çdo punëmarrës të evidentuar në punë pa siguracion, dhe sigurimin e tij konform legjislacionit, pa të cilin nuk lejohet të vazhdojë punën. Të dhënat e inspektimeve të kësaj periudhe tregojnë se nga 2565 punëmarres informal të konstatuar nga të cilët tashmë 97.4% e tyre, brenda procesit të inspektimit, janë bërë pjesë e skemës së sigurimeve shoqërore e shëndetësore, ku minimumi i kostos së munguar në arkën e shtetit për sigurim shoqëror dhe shëndetsor, sikur këto punëmarrës të jenë pjesë e kësaj skeme në vetëm 1 muaj me 26 mijë lekë paga mujore minimale, shifra është 18.5 milion lekë.
 - 682 prej tyre janë konstatuar në inspektime e hapura si çështje të programuara,
 - 1714 konstatuar në çështje inspektimi të hapura në system si çështje në periudha piku të aktiviteteve, kryesisht periudhe e sezonit turistik, në aktivitetet e hoteleri turizmit, orjentim tashmë i përvitshëm ky i ISHPSHSH-së, nisur nga sezoni dhe garantimi i punës së sigurt e të siguruar.
 - 160 punëmarrës informal të konstatuar në rastet e inspektimeve si çështje ankese, të bërë pranë ISHPSHSH-së,
 - 9 konstatime të punëmarrësve të pasiguruar në rastet e inspektimeve si çështje aksidenti në punë.
- ✓ Rritja e besueshmërisë, nëpërmjet trajtimit dhe dhënies zgjidhje të ankesave të ardhura nga punëmarrës dhe punëdhënës.
- ✓ Orientimi i kontrolleve drejt aktiviteteve ekonomike që paraqesin rrezikshmëri të lartë për siguri e mirëqenie në punë, të punëmarrësit.
- ✓ Monitorimi i vazhdueshëm i punës, ndaj gjithë strukturës inspektuese, duke ofruar mbështetje për kryerjen në mënyrë sa më korrekte të detyrës.
- ✓ Rritjen e kujdesit shoqëror komunitar, në respektim të standarteve te reja për tipologji, por edhe rritja e kapaciteteve të pushtetit vendor për ofrimin e shërbimeve në përputhje me nevojat e gjithë komunitetit.
- ✓ Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të kujdesit shoqëror, garantimi i respektimit të shërbimeve me qëllim respektimin e të drejtave të përfituesit dhe mbrojtjen e tij nga diskriminimi, dhuna dhe abuzimi, duke vlerësuar prioritet forcimin e mekanizmave, procedurave të mbrojtjes si dhe rritjen e sensibilitetit të komunitetit ndaj procesit të ankimimit.

Në shërbim të përmirësimeve të vazhdueshme në punën inspektuese, përse i takon zbatimit të plotë dhe gjithpërfshirës të legjislacionit të punës:

ISHPSHSH-ja ka lançuar “Matricën e Dënimeve” si një platformë e aksesueshme në Faqen Zyrtare të institucionit. Kjo platformë, jep ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e kapaciteteve profesionale të inspektorëve të punës, duke mundësuar orientim të qartë në legjislacionin e punës. Gjithashtu përmes saj, sigurojmë një proces inspektimi krejt transparent duke ulur në maksimum abuzimin me detyrën nga inspektorët e punës.

Kërkesat e vazhdueshme drejt Inspektoratit Qëndror, mbi përmirësimet e domosdoshme të sistemit e-inspektimi, për kryerjen e verifikimeve dhe dokumentimin online, të cdo veprimi inspektues, kanë bërë të mundur tashmë marrjen në kohë reale të dokumenteve e-sig 025 dhe e-sig 027, për deklarimet e subjekteve në tatim-taksa si për NIPT ashtu dhe për NID.

Tashmë, sistemi mundëson kryerjen e inspektimeve edhe në subjekte të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre, pa deklaruar adresën sekondare apo nënkontraktore, duke vepruar e ndërhyrë menjëherë për mos abuzime të cdo kujt, në lidhje me sigurinë e shëndetin në vendin e punës apo marrëdhëniet e punës, me cdo punëmarrës.

Jemi në pritje të zhvillimeve të tjera, që lidhen me rastet e aksidenteve në punë gjatë procesit të inspektimit të iniciuar jo për aksident, si dhe rastet e aksidenteve massive.

Rezultatet e kontrolleve 9-mujore 2019:

Analiza e rezultatet e kontrolleve 9-mujore, janë pjesë e kontrolleve të kryera nga 84 inspektor pune në terren:

Lloji i inspektimit	Subjekte te inspektuara	Subjekte me dënime administrative (paralajmerim, gjoba, pezullime)	% e subjekteve me dënime administrative kundrejt totalit të inspektimeve për cdo rast	Punëmarrës pa kontrata pune dhe të pasiguruar
Inspektime të programuara	7645	1329	17%	2434
Inspektime për shkak aksidenti në punë	145	113	78%	255
Inspektime për shkak ankese	426	203	48%	340
Inspektime rastësore (shkelje flagrante evidente)	1826	1166	64%	3451
Total Inspektime	10042	2811	28%	6480
28% e inspektimeve janë inspektime me dënime administrative				

93% e inspektimeve rastësore, janë kryer në periudhën korrik, gusht, shtator 2019 realizuar në aktivitetet e hoteleri turizën më periudhë sezoni turistik.

Të dhënat mbi inspektimet sipas llojit të inspektimit, për degë rajonale janë:


Degët Rajonale	Inspektime të programuara (planifikim apo kërkesa)	Inspektime për shkak aksidenti në punë	Inspektime për shkak ankese	Inspektime rastësore (indicia për shkelje flagrante)	% e inspektimeve jashtë plani kundrejt totalit të inspektimeve
Berat	388	6	9	273	43%
Dibër	203	13	2	57	26%
Durrës	375	19	39	232	44%
Elbasan	629	12	11	151	22%
Fier	674	7	15	60	11%
Gjirokastrë	196	5	0	8	6%
Korçë	601	8	7	145	21%
Kukës	248	6	2	127	35%
Lezhë	315	13	11	98	28%
Shkodër	623	6	20	131	20%
Tiranë	2683	45	271	403	21%
Vlorë	710	5	39	141	21%
Total	7645	145	426	1826	24%

Krahasimisht me të njëjtën periudhë të një vit më parë në këtë 9-mujor kemi, numër të shtuar të rasteve të inspektimeve rastësore për indicje të shkeljeve flagrante të ligjit, si dhe për shkak ankese.

	Inspektime rastësore/për indicje të shkeljeve flagrante	Inspektime për shkak ankese
<i>9-mujori i vitit 2017</i>	4	200
<i>9-mujori i vitit 2018</i>	44	332
<i>9 mujori i vitit 2019</i>	1826	426
<i>raste më shumë këtë vit se një vit më parë</i>	1782	94

Inspektime jashtë programimi, përbëjnë 24% kundrejt totalit të inspektimeve të realizuar në periudhën Janar-Shtator 2019, e ku të analizuara për degë rajonale rezultojnë:

Përqindje e inspektimeve jashtë plani kundrejt totalit të inspektimeve



Disa nga treguesit e përgjithshëm statistikorë të inspektimeve realizuar gjatë kësaj periudhe nga trupa inspektuese e ISHPSHSH-së janë:


Subjekte të inspektuara Private + Shtetërore	10042
Vende pune të inspektuara	219573
Punëmarrëse femra	107641
Mesatare e punëmarrës për subjekt	21.9
Subjekte private të inspektuara	9994
Vende pune të inspektuara në subjektet private	208596
Punëmarrëse femra	104008
Mesatare e punëmarrës për subject në subjekte private	20.9
Punëmarrës pa kontrata individuale të evidentuar	3915
Punëmarrëse femra pa kontrata individuale	1468
Punëmarrës informal të evidentuar	2565
Punëmarrëse informale femra të evidentuar	882
Punëmarrës informal të futur në skemën e SSH	2498
Punëmarrëse informale femra të futur në skemën e SSH	863
Punëmarrës nën 18 vjeç të evidentuar	237
Punëmarrëse femra nën 18 vjeç të evidentuara	81

Punëmarrës të huaj të evidentuar	903
Punëmarrës të huaj, pa leje pune	18
Punëmarrës me aftësi të kufizuar	157
Punëmarrëse femra me aftësi të kufizuar	54
Subjekte për të cilët është mbajtur masë administrative “Pezullim” për shkelje të dispozitave ligjore të marrëdhënieve të punës	1371
Subjekte për të cilët është mbajtur masë masë administrative “Pezullim” për shkelje të dispozitave ligjore të sigurisë e shëndetit në punë	94
Subjekte me masën administrative “Paralajmërim”	1230
Subjekte me masën administrative Gjobë”	116
Vlera totale e sanksioneve (lekë)	28444200
Inspektime të programuara	7645
Inspektime për shkak Ankese	426
Inspektime për shkak Aksidenti	145
Punëmarrës të aksidentuar	131
Punëmarrëse femra të aksidentuara	16
Punëmarrës të aksidentuar me vdekje	30

Aktivitetet ekonomike të inspektuara kjo rezultat I llojit të aktiviteve që operojnë më së shumti në Shqipëri dhe orjenitimit për shkak të sezonit, janë në masën 51% aktivitete Tregëti, hotel-bar-restorante.

Më konkretisht të dhënat në shifra rezultojnë:

Lloji i aktivitetit	Inspektime
Bujqesi pyje peshkim	154
Miniera kariera	212
Ndermarrje prodhuese	1,885
Elekticitet gaz uje	93
Tregeti H-B-R	5,110
Ndertim	823
Transport, telekomunikacion	194
Finance sherbime të sigurimeve	110
Aktivitete të tjera	1,461
Total	10,042




Orjentimi i inspektimeve, bazuar në analiza të të dhënave nga inspektimeve të mëparshme, duke vlerësuar nivelin e riskut për subject, llojin e aktivitetit për periudha kohore e nevojën për treg pune, rastet e përsërituar të ankesave e aksidenteve në punë, cuan në rritjen e masave administrative të mara në inspektimet e realizuara, për subjekte të inspektura në periudhat respektimve kohore.

Domosdoshmëria e zbatimit të dispozitave ligjore nga të gjithë subjektet ekonomike, e patoleruar në kurriz të punëmarrësve, ka sjell dhe rritjen e forcës goditëse të inspektorit të punës, në 0.7 herë më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Periudhat e inspektimeve	9 mujore 2018	9 mujore 2019
Subjekte të Inspektuara	7757	10042
Masa administrative të aplikuara	1501	2811
Përqindje e subjekteve me masa administrative kundrejt subjekteve të inspektuara	19%	28%


Përqindje e subjekteve me masa administrative kundrejt subjekteve të inspektuara, në 12 degët rajonale rezultojn:




Marrja e masave administrative për shkelësit e ligjit janë në të shumtën e rasteve pezullimi i pjesshëm apo i të gjithë aktivitetit, për shkelje flagrante të legjislacionit të punës si në drejtim të marrëdhënieve të punës jo korrekte, ashtu dhe të shkeljes së dispozitave ligjore për siguri e shëndet në vendin e punës, e ku marrja e masave të menjëhershme për rregullimin e situatës është domosdoshmëri.

Masat administrative kryesore për shkelje të dispozitave ligjore janë “paralajmërim” dhe “gjobë”.

Në inspektimet e realizuara në këtë 9-mujor këto masa janë:



Aktivitetet e ku masat administrative për shkelje të dispozitave ligjore janë aktivitetet miniera kariera, e aktivitetet ndërtuese e prodhim të materialeve të ndërtimit, të cilat për shkak edhe të aktivitetit që zhvillojnë, janë me një nivel të lartë e shumë të lartë rrisi sa u takon sigurisë e shëndetit në punë, dhe më së shumti për masat e parandalimit të aksidenteve në punë. (Këtu sqarojmë se rastet e minierave për sa u takon kushteve të sigurisë në punë, janë organe të tjera kontrolluese e monitoruese, por cdo rast i inspektuar edhe nga ISHPSHSH-ja reflekton masa administrative).



Masat administrative, ndaj subjekteve të inspektuara, sipas rastit e llojit të inspektimit, janë më ndëshkuese në inspektimet e aksidenteve në punë, ankesave dhe inspektimeve rastësore, ku 78% e inspektimeve për aksident në punë janë me masa të tilla, dhe 64% e inspektimeve për shkak ankese, janë me masa administrative. Këtu, nuk duhet lënë jashtë vëmëndjes, inspektimet e tjera, ku në masën 82% e aktiviteteve të kontrolluara vendimet e inspektimit janë me shkelje të dispozitave ligjore dhe me detyra konkrete ma afate kohore për realizim.

	Inspektime	Subjekte me masa administrative	Përqindje e subjekteve me masa kundrejt inspektimeve përkatëse
Në inspektime të tjera	7645	1329	17%
Në inspektime për aksident në punë	145	113	78%
Në inspektime për shkak ankese	426	203	48%
Në inspektime rastësore (shkelje flagrante)	1826	1166	64%

Një shpërndarje e masave administrative për llojet e aktivitetit, sipas masës së marrë janë:

	Pezullim/për shkelje të dispozitave ligjore për marrëdhënie pune	Pezullim/ për shkelje të dispozitave ligjore për sigurinë në punës	Subjekte me Paralajmerim	Subjekte me gjobe	Vlere (ne lekë)
Bujqesi pyje peshkim	3	0	6	1	260000
Miniera kariera	8	30	83	11	5112000
Ndermarrje prodhuese	121	10	306	31	5312000
Elektricitet gaz uje	14	0	15	2	1040000
Tregeti H-B-R	1037	4	477	21	4297000
Ndertim	78	46	150	26	7734000
Transport, telekomunikacion	7	1	27	0	0
Financë, sherbime të sigurimeve	7	0	3	1	260000
Te tjera	96	3	163	23	4429.200
Total	1371	94	1230	116	28444.200

Për masa administrative të mara apo shkelje të dispozitave ligjore lënë në vendim përfundimtar të inspektimit, cdo subject, ka të drejtën e ankimit. Pranë ISHPSHSH-së gjatë këtij 9-mujori, janë ankimuar 32 vendime inspektimi 94% e tyre janë lënë në fuqi, nga komisioni i apelit, pranë ISHPSHSH-së.

Inspektime për aksident në punë

Për periudhën Janar-Shtator 2019 janë regjistruar dhe për të cilët ka përfunduar hetimi administrativ i aksidentit në punë për **122 raste të aksidenteve**, ku janë lënduar gjatë punës në të gjitha llojet e aktiviteteve **131 punëmarrës** prej të cilëve **30 me pasojë të humbjes së jetës**, aksidente që kanë përfshirë **125 subjekte**.

Për 75.6% e punëmarrësve të aksidentuar shkaqet lidhen drejtpërdrejtë me kushtet e sigurisë dhe shëndetit në punë, dhe 73.3% e aksidenteve me pasojë fatale për jetën kanë ndodhur për këto shkaqe.

	Punëmarrës të aksidentuar	Të aksidentuar me pasojë vdekejn
AKSIDENTE	131	30
Aksidente që lidhen direkt me punën	99	22
Aksidente që lidhen direkt me punën (pa minierat)	77	16
Aksidente në rrugë	18	4
Aksidente në miniera	22	6
Aksidente për shkaqe të tjera, të palidhura dpd me punën	14	4

Nisur nga shkak i ndodhjes së tyre, në tabelën më lart janë specifikuar rastet kur aksidenti i ndodhur ka ardhur si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e kushteve të punës, si edhe rastet kur ngjarja vlerësohet për shkak të ligjit si aksident në punë, duke i trajtuar punëmarrësit nga skema e sigurimeve si të aksidentuar gjatë punës. 24.4% e punëmarrësve të aksidentuar në punë janë aksidentuar për shkaqe të ndryshme nga ato të kushteve të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe nëse zbresim edhe rastet e aksidenteve në miniera të cilat nuk janë në kontrollin e drejtpërdrejtë të inspektorit të punës, kjo shifër shkon në 58.7% e rasteve të aksidenteve të ndodhura lidhen drejtpërdrejt me punën dhe që janë nën kontroll të inspektorit të punës.

Kështu, sqarojmë se:

- Në subjektet me aktivitet miniera, kariera janë regjistruar 22 punëmarrës të aksidentuar në punë, nga të cilët 6 me pasoja fatale për jetën. Këto subjekte janë objekt kontrolli nga ana e ISHPSHSH-së, ku inspektori i punës konfirmon rastet e aksidenteve të ndodhura në punë, por verifikimi i kushteve të sigurisë dhe shëndetit në nëntokë, kryhet nga AKSEM (Autoriteti Kombëtar i Sigurisë dhe Emergjencave në Miniera). Në rastet e aksidenteve në punë në këto subjekte, inspektori i punës plotëson “Provesverbalin e Aksidentit në Punë” në bazë të relacionit të mbajtur nga ky institucion (AKSEM), i cili përcakton edhe shkakun e ndodhjes së ngjarjes dhe rregullat e shkelura.
- Në bazë të ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” vlerësohen si aksidente në punë edhe rastet kur aksidenti ka ndodhur rrugës në linjën e drejtpërdrejtë nga banesa për në punë dhe anasjelltas, si në rastet kur transporti është i organizuar nga punëdhënësi ashtu edhe individualisht nga punëmarrësi, si edhe rastet kur gjatë kryerjes së punës janë goditur nga një automjet. Këto përbëjnë 18 raste të aksidentuarve të ndodhura ose 13.7 % të aksidenteve të ndodhura, 4 prej të cilëve me pasojë të humbjes së jetës ose 13,3% të rasteve të aksidenteve me vdekje.
- Në grupimin “Raste të aksidenteve për shkaqe të tjera, të palidhura drejtpërdrejt me punën” janë shënuar rastet të tilla si:
 - Gjendja shëndetësore e punëmarrësve, jo sëmundje e përgjithshme, ku gjatë orarit të punës kanë pësuar infarkt, marrje mendsh. Janë regjistruar 5 punëmarrës në këtë gjendje, ku 2 prej të cilëve, infarkti ka sjellë humbje të menjëhershme të jetës. Përgjithësisht këto raste kanë ndodhur në përfundim apo menjëherë me fillimin e punës dhe është konstatuar që mungonte raporti mjekoligjor apo mbulimi i subjektit me shërbim mjekësor.
 - Goditje nga persona të tretë për shkak të detyrës, ku janë regjistruar 2 raste, në aktivitete “Të tjera” , ku punëmarrësit (meshkuj) me pozicion pune: punonjes në një zyrë këmbimi valutash dhe roje sigurie, janë goditur nga persona të tjerë. Këto janë raste pa pasojë fatale për jetën, por me pasoja të rënda për shëndetin, duke shkaktuar paafësi mbi 20 ditë /2muaj.
 - Kushteve atmosferike të kohës, ku dy nga katër rastet e ndodhura me këtë natyrë, rezultuan me pasoja fatale për jetën. Ishin punëtorë mirëmbajtje dhe shitës karburanti, ku era shume e fortë ka sjellë dëme materiale dhe në njerëz.
 - Janë 2 raste ku kemi sulmin nga një qen dhe pengim i mësues nga një nxënës që anë sjellë rrëzimin e tyre dhe si pasojë thyerje apo shembje në pjesë të ndryshme të trupit. Njëri nga rastet ka ardhur në formën e denoncimit, rast i panjoftura nga subjekti në kohë pranë ISHPSHSH-së.

- Një rast kur mësuesja pengohet nga një nxënës dhe rrëzohet duke pësuar dëmtim të mjekrrës dhe një rës nga kockat e parakrahur të majtë.

Duke zbritur këto raste të cituara më sipër, aksidente të ndodhura gjatë punës dhe që lidhen drejtpërsëdrejti me kushtet e sigurisë dhe të shëndetit në punë janë 99 punëmarrës, ose 78 nëse zbrisim edhe aksidentet në miniera, të cilat nuk monitorohen në nëntokë nga ISHPSHSH.

Janë regjistruar edhe **6 raste të aksidenteve masive**, të ndodhura në 9 subjekte, ku kanë mbetur të lënduar 15 punëmarrës, nga të cilët 3 me pasojë humbje jete.

Degët Rajonale të ISHPSHSH-së Tiranë, Dibër, Durrës dhe Lezhë. Raste të aksidentve masive, janë shënuar si në formën e prekjës së disa subjekteve nga e njëjta ngjarje, ashtu edhe që në të njëjtën ngjarje janë aksidentuar dy apo më shumë punëmarrës. Në këto ngjarje janë lënduar. Rastet e aksidenteve masive përbërjé kështu 5% të rasteve të aksidenteev të ndodhura.

1.2 Aksidente në grupe të riskuara / mbrojtje të veçantë

a) Femra të aksidentuara

19 nga punëmarrësit e aksidentuar janë **femra**, pa pasoja fatale për jeten, me shtëtësi shqiptare. Mosha mesatare e femrave të aksidentuara është 40. Sektorët në të cilët janë shënuar këto raste janë kryesisht në subjektet me aktivitet “fasoneri”, “prodhim” dhe “Të tjera”. Pozicioni i tyre i punës përgjithësisht ishte sanitare, mësuese, shitëse, punëtore, rrobaqepëse, juriste, pjatalarëse, punonjëse pasticerie, mjeke.

9 nga rastet e ndodhura nuk janë të lidhura drejtpërdrejtë me kushtet e sigurisë dhe të shëndetit në punë, nisur nga shkakut i ndodhjes së tyre, ku mund të përmendim: prania e ngricave në ambjettet e shkollës që ka sjellë rrëshkitje; aksidente rrugore nga puna për në shtëpi dhe anasjelltas, penguar nga një nxënës dhe rrëzohet, marrje mendsh që ka sjellë rrezimin, sulmimi nga një qen, ku edhe pasojat më të rënda mbi 2 javë janë shënuar në këto raste. Përsa i përket llojit të dëmtimit kanë pësuar frakturë (duar, këmbë dhe mjeker).

Si shtrirje gjeografike, këto subjekte kanë ndodhur në Tiranë, Durrës, Fier dhe Korçë, Lezhë, Vlorë.

26.3% e rasteve të aksidenteve në të cilat janë aksidentuar punëmarrëse femra, janë të panjoftuara nga subjekti, si dhe në 42% të këtyre rasteve ndaj subjekteve janë marrë dënime administrative kryesore gjobë ose paralajmërim, ndërsa në rastet në të cilat janë lënë vetëm detyra për realizim janë përgjithësisht ato, kur ngjarja e ndodhur nuk lidhej drejtpërdrejtë me kushtet e punës.

b) Nuk ka pasur raste të fëmijëve të aksidentuar gjatë punës.

c) Nuk ka pasur persona me aftësi të kufizuar të aksidentuar gjatë punës.

d) Punëmarrës të huaj

Janë regjistruar dy punëmarrës të huaj të aksidentuar, të cilët ishin punonjës në minierë, në zonën e Dibërës, pa pasoja fatale për jetën. Ishin të pajisur me leje pune.

	Inspektime per aksident							
Deget Rajonale	Gjithsej	Pezullim/M	Pezullim/S	Paralajmerim	Gjobe	Vlere (.000)	P/aksidentuar	P/A/vdekje
Berat	6	0	1	3	2	1040	4	2
Diber	13	0	0	9	1	260	15	3
Durres	19	2	3	14	5	902	16	2
Elbasan	12	0	2	7	4	1080	11	4
Fier	7	0	0	1	3	460	7	1
Gjirokastr	5	0	0	0	1	100	3	2
Korce	8	0	0	2	2	360	8	2
Kukes	6	0	0	3	1	260	4	1
Lezhe	13	3	1	5	4	1680	11	4
Shkoder	6	0	0	0	3	1050	4	3
Tirane	45	1	1	4	19	5112	42	6
Vlore	5	0	0	4	2	150	6	0
Qender	0	0	0	0	0	0	0	0
Total	145	6	8	52	47	12454	131	30

Sipas degëve rajonale kemi që numri më i madh i inspektimeve për rast aksidenti në punë është kryer në degën rajonale Tiranë, Durrës, Dibër dhe Lezhë

Sa i takon inspektimeve për aksident në punë rezultojnë se në 36% të rasteve të inspektimit për shkak aksidenti është marrë masa administrative “Paralajmërim”, dhe në 32 % të rasteve është marrë masa administrative “Gjobjë”.

Sipas llojit të aktivitetit ekonomik rastet e aksidenteve në punë rezultojnë:

9-mujori i viti 2019	Subjekte të inspektuara për shkak aksidenti në punë	Punëmarrës të aksidentuar	Punëmarrës të aksidentuar, me vdekje
<i>Bujqësi, pyje ,peshkim</i>	1	1	0
<i>Miniera, karriera</i>	20	22	6
<i>Ndërmarrje prodhuese</i>	34	25	2
<i>Elektricitet, gaz, ujë</i>	7	5	2
<i>Tregti, hotel-bar-restorante</i>	10	9	1
<i>Ndërtim</i>	41	38	14

<i>Transport, telekomunikacion</i>	1	1	0
<i>Finance, shërbime të sigurimeve</i>	0	0	0
<i>Aktivitete të tjera</i>	31	30	5
Total	145	131	30

Të dhëna për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, evidentuar gjatë muajve Janar-Shtator 2019

Subjekte ku ekziston dokumentit te vlerësimit të riskut	188
Subjekte ku ekziston këshilli i sigurisë dhe shëndetit në punë	2426
Numri i punëmarrësve të dyshuar, për sëmundje profesionale	40
Nr i punëmarrësve të diagnostikuar me sëmundje profesionale	35
Subjekte ku ka Shërbimi me mjek ndërmarrje	1799
Numri i punëmarrësve që punjnë me substanca të rrezikshme (te ekspozuar ndaj tyre)	2927
Nr i punëmarrësve që përdorin Pajisje mbrojtëse individuale	79658
Subjekte ku janë marrë Masat mbrojtëse kolektive	3619
Subjekte ku ekziston koordinatori për Sigurinë dhe shëndetin	532
Subjekte ku ekziston përfaqësuesi/Këshillit të sigurisë dhe Shëndetit në Punë	760
Subjekte ku ekziston shërbimi i ndihmës së parë	43
Subjekte ku kryhet Kontrolli periodik i punëmarrësve	1625

Inspektime për shkak ankese

Ankesat e ardhura drejt Institucionit tonë si shkak i ndërgjegjësimit të punëmarrësve dhe punëdhënësve, janë gjithnjë e në rritje, ku në total gjatë kësaj periudhe, janë trajtuar 600 ankesa nga të cilat 426 me procedurë inspektimi.

Sa i takon zgjidhjes nuk është parë vetëm dhënia e të drejtës personit që adreson denoncimin, por dhe luftimi i fenomenit, i cili përmirëson marrëdhënien e punësimit për punëmarrësit që prekeshin nga e njëjta problematikë.

Janë trajtuar dhe denoncime të tjera të cilat janë trajtuar pa procedurë inspektimi por me të gjithë seriozitetin e duhur, duke dhënë informacionin e nevojshëm sipas rastit dhe delegim në Autoritetet përkatëse sipas fushës së kompetencës dhe specifikës që paraqitej.

Nga janari i këtij viti kjo shifër së bashku me inspektimet për ankesë rezultojnë 600 ankesa të regjistruara dhe të trajtuara. Rreth 35 % e rasteve të trajtuara pa procedurë inspektimi, janë sqaruar në lidhje me pozicionin e tyre në raport me Legjislacionin e punës apo janë deleguar për kompetencë

në organe të tjera ligjzbatuese, por që janë trajtuar me seriozitet maksimal nga struktura jonë. Vlen të theksojmë se të gjithë rastet e adresuara pranë nesh jemi kujdesur që të marrin përgjigje në kohën e duhur.

Nga “Platforma e Bashkëqeverisjes” janë adresuar pranë nesh 82 raste që denonconin shkelje të legjislacionit të punës, ose 23% e të gjithë denoncimeve të ardhura.

Sa i takon inspektimeve për shkak ankese rezultojnë se në 34 subjekte ose në 8% të rasteve është marrë dënim kryesor “Gjobë”, ndërkohë në 112 subjekte ose në 26 % të këtyre inspektimeve është marrë dënim kryesor “paralajmërim”.

Inspektime për ankesë Janar-Shtator 2019

<i>Deget Rajonale</i>	Inspektime për shkak ankese	Pezullim/shkelje flagrante të marrëdhënie të punës	Pezullim/shkelje flagrante të sigurisë në punë	Masë administrative Paralajmërim	Masë administrative Gjobe	Vlere (.000)
<i>Berat</i>	9	1	0	9	0	0
<i>Diber</i>	2	0	0	0	0	0
<i>Durres</i>	39	4	0	19	4	1140
<i>Elbasan</i>	11	1	0	2	1	260
<i>Fier</i>	15	1	0	4	0	0
<i>Gjirokaster</i>	0	0	0	0	0	0
<i>Korçë</i>	7	0	0	1	1	52
<i>Kukës</i>	2	1	0	0	1	2002
<i>Lezhë</i>	11	1	1	7	1	312
<i>Shkodër</i>	20	4	0	0	3	1030
<i>Tiranë</i>	271	32	5	46	19	4114
<i>Vlorë</i>	39	6	0	24	4	350
<i>Total</i>	426	51	6	112	34	9260

Numri më i madh i ankesave të trajtuara në këtë muaj është realizuar nga Dega Rajonale Tiranë me 271 inspektime për shkak ankese. Ndërkohë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë kemi:

Sipas llojit të aktivitetit ekonomik, inspektimet e kryera per rast ankese janë:

Lloji i aktivitetit	Subjekte të inspektuara për shkak nkese
Bujqësi, pyje ,peshkim	1
Miniera, karriera	5
Ndërmarrje prodhuese	105
Elektricitet, gaz, ujë	3
Tregti, hotel-bar-restorante	93
Ndërtim	19
Transport, telekomunikacion	12
Financë, shërbime të sigurimeve	11
Aktivitete të tjera	177
Total	426

Punëmarrësit.

Në lidhje me punëmarrësit e evidentuar në punë rezulton se:

49% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrëse femra

1.7 % e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës që punojnë pa kontrata individuale pune.

29.4% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës të siguruar në bazë të pagës minimale.

0,04 % e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës të huaj.

0.07% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës me aftësi të kufizuar.

0.1% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës nën 18 vjeç.

1,2 % e punëmarrësve të evidentuar ishin punëmarrës të pasiguruar (informal)

0.05 % e punëmarrësve të evidentuar ishin të aksidentuar.

Kontrata individuale të punës në subjektet private:


Janë 3720 punëmarrës të evidentuar në aktivitetet private të inspektuara ose 1.8% e totalit të punëmarrësve që janë konstatuar gjatë inspektimeve në muajt Janar-Shtator 2019 pa kontrata pune individuale.

Më konkretisht, numri i punëmarrësve evidentuar në punë pa kontrata pune individuale në 12 prefekturat e Vendit në subjekte private është:

Degët Rajonale**Aktivite private të inspektuara Janar-Shtator**

		Subjekte	Punëmarrës	Punëmarrës pa kontrata	% e Punëmarrësve pa kontrata
1	Berat	671	7473	205	0.3%
2	Dibër	269	7606	96	0.5%
3	Durrës	661	22207	219	1.0%
4	Elbasan	798	9083	222	1.3%
5	Fier	755	15997	43	1.9%
6	Gjirokastrë	207	2048	204	2.2%
7	Korçë	760	8570	192	2.4%
8	Kukës	379	2274	224	2.7%
9	Lezhë	433	6361	280	4.4%
10	Shkodër	779	11548	223	9.3%
11	Tiranë	3397	101024	474	9.9%
12	Vlorë	885	14405	1338	10.0%
	SHUMË	9994	208596	3720	1.8%

Punëmarrës pa kontrata pune individuale kundrejt totalit të punëmarrësve të evidentuar në aktivitetet private të inspektuara, sipas degëve rajonale



Duke analizuar të dhënat mbi punëmarrësit e evidentuar pa kontrata pune individuale në llojet e aktiviteteve të kontrolluara rezulton se në këtë 9-mujor në inspektimet e kryera nga ana sasiore numri më i lartë i punëmarrësve që punonin pa kontrata pune individuale është konstatuar në aktivitetet tregëtare, bar-hotel-restorante:

Këto rezultate paraqiten si më poshtë:

Lloji i aktivitetit	Inspektime (subjekte private)	Punemarres	Pa kontrata	Pa kontrata Femra	% e punm. pa kontrata individuale
Bujqësi, pyje, peshkim	154	1062	42	38	4.0%
Miniera, karriera	210	8521	54	6	0.6%
Ndërmarrje prodhuese	1881	80841	440	238	0.5%
Elektricitet, gaz, ujë	79	8224	17	5	0.2%
Tregti, hotel-bar-restorante	5110	40939	2412	909	5.9%
Ndërtim	822	15233	403	25	2.6%
Transport, telekomunikacion	194	3689	88	31	2.4%
Finance, shërbime të sigurimeve	110	2090	13	3	0.6%
Aktivitete të tjera	1434	47997	251	86	0.5%
Total	9994	208596	3720	1341	1.8%

Punësimi informal :


Gjatë inspektimeve të realizuara në periudhën 9-mujore 2019, janë evidentuar të punojnë të pasiguruar, gjithsej 2565 punëmarrës, për të cilët pas marrjes së masave administrative “pezullim”, deri në përfshirjen e tyre në skemën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, gjatë procesit të inspektimit, janë siguruar 2498 prej tyre.

Këtë vit periudha e sezonit turistik ku konsiston dhe me numrin më të madh të informalëve të evidentuar, është rezultat i planit operacional të ndërmarrë, ku është operuar me inspektime të trupës inspektuese në zona gjeografike me aktivitet të shtuar gjatë sezonit turistik. Inspektimet nuk ishin në grupe të përbashkëta me dëgët e tatim-taksave, por me mbështetjen e tyre në koordinimin veprimesh, e shkëmbim informacioni.

Inspektimet janë kryer edhe në ditët e pushimit javor, dhe në orët e turneve.

Të dhënat krahasuese me inspektimet e viteve të fundit, janë dukshëm për numër të shtuar të evidentimit dhe formalizimit të punësimit informal, pasi në vitet e tjera, nuk është operuar me lëvizje të trupës inspektuese, në zona gjeografike me aktivitet të shtuar sezonal.

Të dhëna mbi informalitetin e konstatuar në vite



Lloji i inspektimit	Subjekte te inspektuara	Punëmarrës	Punëmarrës të pasiguruar	Punëmarrës të siguruar gjate procesit
Inspektime të programuara	7645	143450	682	669
Inspektime për shkak aksidenti në punë	145	16393	9	8
Inspektime për shkak ankese	426	47008	160	132
Inspektime rastësore (shkelje flagrante evidente)	1826	12722	1714	1689
Total Inspektime	10042	219573	2565	2498

Sipas llojit të aktivitetit ekonomik, informaliteti në aktivitetet private rezulton :

Lloji i aktivitetit	Inspektime (subjekte private)	Punemarres	Punëmarrës të pasiguruar	Femra të pasiguruara	% e punm femra te pasiguruara
Bujqësi, pyje, peshkim	154	1062	5	0	0.0%
Miniera, karriera	210	8521	36	5	13.9%
Ndërmarrje prodhuese	1881	80841	245	154	62.9%
Elektricitet, gaz, ujë	79	8224	16	5	31.3%
Tregti, hotel-bar-restorante	5110	40939	1,776	617	34.7%
Ndërtim	822	15233	259	7	2.7%
Transport, telekomunikacion	194	3689	38	14	36.8%
Finance, shërbime të sigurimeve	110	2090	8	4	50.0%
Aktivitete të tjera	1434	47997	175	72	41.1%
Total	9994	208596	2,558	878	34.3%

Sipas degeve rajonale punëmarrësit informal të evidentuar janë:

Degët rajonale	Punemarres te pasiguruar	Punëmarrës, siguruar gjatë procesit të inspektimit
Berat	42	42
Diber	62	62
Durres	426	422
Elbasan	172	171
Fier	47	47
Gjirokaster	14	14
Korce	246	242
Kukes	235	197
Lezhe	116	116

Shkoder	213	204
Tirane	548	539
Vlore	444	442
Total	2565	2498

- **Paga**

Punësimi me pagë minimale rezulton evident në 31% të punëmarrësve të evidentuar në punë në aktivitetet private të inspektuara, e ku aktivitetet si: bujqësi, pyje peshkim, tregëti hotel-bar-restorante e transport telekomunikacion, ku sigurimi i punëmarrësve kryhet mbi pagë minimale, rezulton mbi 50% të totalit të punëmarrësve të evidentuar për aktivitetet.

Lloji i aktivitetit	Inspektime (subjekte private)	Punemarres	Punemarres, siguruar me page minimale	Punëmarrëse femra të siguruara me page minimale	Përqindje e punëmarrësve të siguruar me page minimale	Përqindje e punëmarrësve femra të siguruar me page minimale
Bujqesi pyje peshkim	154	1,062	736	303	69.3%	41.2%
Miniera kariera	210	8,521	667	87	7.8%	13.0%
Ndermarrje prodhuese	1,881	80,841	26,045	18,832	32.2%	72.3%
Elektricitet gaz uje	79	8,224	237	61	2.9%	25.7%
Tregeti H-B-R	5,110	40,939	20,871	8,587	51.0%	41.1%
Ndertim	822	15,233	5,537	490	36.3%	8.8%
Transport, telekomunikacion	194	3,689	2,012	733	54.5%	36.4%
Finance sherbime	110	2,090	445	167	21.3%	37.5%
Te tjera	1,434	47,997	7,918	3,348	16.5%	42.3%
Total	9,994	208,596	64,468	32,608	30.9%	50.6%

TURIZMI NË ZBATIM TË PLANIT OPERACIONAL DHE ANGAZHIMIT INSTITUCIONAL

Në kuadër të Aksionit kundër Informalitetit të ndërmarrë nga MFE, ISHPSHSH-ja nga 1 korrik 2019 e në vazhdim është angazhuar dhe ka orjentuar punën në:

- inspektimet e subjekteve me aktivitet të shtuar në sezonin turistik veror 2019 e me risk të shtuar informaliteti të tregut të punës,
- inspektime drejt subjekteve të vlerësuara deri tani me rrisht të lartë e shumë të lartë sa u takon sigurisë dhe shëndetit në punë,

Si rezultat i zbatimit të “Planit Operacional”, deri tani janë:

- 3439 subjekte të kontrolluara gjithsej, nga të cilat në 1083 subjekte (31%) është konstatuar punësim informal dhe në 1537 raste apo në 45% të subjekteve të kontrolluara, janë marrë masa administrative, pasi kanë rezultuar me problematika në raport me zbatimin e ligjit.

Konkretisht:

- 1138 raste janë masa administrative “pezullim”, aplikuar në masën 33% të subjekteve të kontrolluara, e që zënë 74% të masave administrative, ku për shkeje flagrante të dispozitave ligjore për marrëdhënie pune e siguri në punë, ku masat “pezullim” për shkelje të dispozitave ligjore për marrëdhënie pune zënë 95% të këtyre pezullimeve dhe 5% janë masa “pezullimi” aktiviteti, për shkelje flagrante të masave të sigurisë e shëndetit në punë.
 - 353 raste janë masa administrative “paralajmërim”, aplikuar në masën 10.3% të subjekteve të kontrolluara për shkelje të dispozitave ligjore të legjislacionit të punës, e që zënë 23% të masave administrative.
 - 46 raste janë masa administrative “gjobë” aplikuar në masën 1.3% të subjekteve të kontrolluara, për shkeje flagrante të dispozitave ligjore për marrëdhënie pune e siguri në punë, e që zënë 3% të masave administrative.
- Për 63.138 punëmarrës gjithsej është verifikuar marrëdhënia e punësimit të tyre ku 1922 punëmarrës prej tyre kanë rezultuar të punojnë të pasiguarur dhe të padeklaruar në skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore. Shifra e informalitetit të evidentuar është në masën 29% në 1083 subjektet të cilët kanë rezultuar me 6586 të punësuar gjithsej dhe që kanë rezultuar me problematikën e informalitetit.

Në 1902 subjektet e kontrolluara pra 55% 5 subjekteve të kontrolluara, janë këshilluar për zbatimin e legjislacionit të punës, si përmes lënies së këshillave në dokumentin e inspektimit ashtu dhe përmes shpërndarjes së fletëpalosjeve informuese me të drejta dhe detyrimeve të punëdhënësve dhe punëmarrësve.

Rezultatet e inspektimeve të kësaj periudhe, kemi mundësuar formalizim për 1893 punëmarrës informale, ku minimumi i kostos së munguar në arkën e shtetit për sigurim shoqëror dhe shëndetsor, sikur këto punëmarrës të jenë pjesë e kësaj skemë në vetëm 1 muaj me 26 mijë lekë paga mujore minimale, shifra është 13.7 milion lekë. Pjesa tjetër prej 29 punëmarrësish që u konstatuan të punojnë të padeklaruar janë dërguar pranë Degëve Rajonale të Tatim Taksave.

Ndërkohë të dhënat e inspektimeve sipas periudhave kohore rezultojnë:

Te dhenat e inspektimeve	Inspektime Total	Nr i Punëmarresve	Inspektime per ankese	Inspektime rastesore	Inspektime per aksident
Total/Korrik	1,396	22,531	50	349	16
Total/Gusht	802	10,552	44	648	19
Total/Shtator	861	22,101	64	704	27
Total/tetor -vazhdon	380	7954	38	96	8
TOTALE/Korrik-13 tetor	3,439	63138	196	1,797	70
Ne perqindje			5.7%	52.3%	2%

Sipas llojit të aktiviteteve ekonomike, rezulton se aktivitetet ku më së shumti ishte e nevojshme ndërhyrje me masa administrative janë minisera kariera dhe aktivitete ndertimi.

Lloje aktiviteti	Subjekte te Inspektuara	Masa administrative	% e masave kundrejt inspektimeve
Bujqesi pyje peshkim	30	-	0%
Miniera kariera	43	26	60%
Ndermarrje prodhuese	331	137	41%
Elektricitet gaz uje	25	15	60%
Tregeti H-B-R	2,488	1,120	45%
Ndertim	238	138	58%
Transport, telekomunikacion	28	10	36%
Finance sherbime	15	6	40%
Te tjera	241	85	35%
Total	3,439	1,537	45%

• Inspektimi në Subjekte Fason

Në fokus të inspektimeve kanë qënë dhe subjektet Fason ku janë realizuar 231 Inspektime ose 5% e inspektimeve në subjekte private, me një numër 24876 punëmarrësish.

Numri i punëmarrësve që punojnë pakontratë individuale pune në këto lloj aktiviteti është shumë i ulët. Janë vetëm 159 punëmarrës që gjatë inspektimeve rezultuar të punojnë pa kontratë pune individuale nga 24876 punëmarrës në total.

Numri i punëmarrësve evidentuar të punonin informal është 50 për të cilët nëpërmjet marrjes së masës urgjente “Pezullim” të punës së tyre në 52 subjekte, deri në formalizimin dhe deklarimit pranë Tatim-Taksave, tashmë ato rezultojnë të futur në skemën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Rreth 38.5% e punëmarrësve të evidentuar në punë në fasoneri rezultojnë që kontributi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore të llogaritet mbi pagë minimale dhe 0.21 % rezultojnë që të punojnë në turn të dytë.

Nr	Dega	Subjekte	Nr. P/M	Nr i Punëm, në turn të II-të (19 ⁰⁰ 22 ⁰⁰)	Nr i Punëmenen 18 vjeç	Nr i Punëm, pa kontratë individuale	Nr. Punëm, të pa siguruar	Nr. Punëm, që u futen në skemën e Sig	Nr punm, të siguruar me page min.
1	Berat	12	2288	3	0	0	0	0	1696

2	Dibër	3	243	4	0	1	1	1	45
3	Durrës	30	2395	0	4	0	0	0	0
4	Elbasan	8	343	0	0	0	0	0	269
5	Fier	20	2951	0	0	0	0	0	1948
6	Gjirokastrë	5	193	0	0	10	0	0	134
7	Korçë	25	1076	0	0	24	24	24	477
8	Kukës	1	103	0	0	0	0	0	101
9	Lezhë	15	2371	40	12	92	14	14	1265
10	Shkodër	18	1878	0	7	1	1	1	1094
11	Tiranë	70	8683	0	0	2	5	5	1592
12	Vlorë	24	2352	5	27	29	5	5	980
	Total	231	24876	52	50	159	50	50	9601

Nga 231 subjekte Fason të inspektuara gjatë kësaj periudhe 47 kanë shkuar me masën administrative paralajmërim, dhe 6 subjekte me sanksion në vlerën 1 720 000 lekë.

Dega	Subjekte	Masë urgjente për marredhënie pune	Masë urgjente për sigurinë në punë	Paralajmërim	Sanksion	Vlerë e gjobës (.000)
Berat	12	0	1	5	0	0
Diber	3	1	0	0	0	0
Durres	30	0	0	3	1	100
Elbasan	8	0	0	0	0	0
Fier	20	0	0	2	0	0
Gjirokaster	5	0	0	0	0	0
Korce	25	3	0	4	0	0
Kukes	1	0	0	1	0	0
Lezhe	15	3	0	5	1	520
Shkodër	18	0	0	0	1	480
Tiranë	70	5	1	6	2	520
Vlore	24	3	0	21	1	100
Total	231	15	2	47	6	1720

Fenomeni evident në këto lloje aktivitetesh është numri i punëmarrësve-kursantë. Kështu nga të dhënat e inspektimit rezultojnë gjithsej 2570 kursantë nga të cilët 143 janë kursantë të marrë përmes Zyrave të Punësimit dhe 2427 rezultuan kursantë të kontaktuar drejtpërdrejtë nga vetë subjektet.

Dega	Subjekte	Nr. P/M	Nr i Punëm Kursante, mare permes zyres se punës	Nr i Punëm Kursante kontaktuar drejtperdrejte nga subjekti
Berat	12	2288	20	0
Dibër	3	243	25	0
Durrës	30	2395	0	0
Elbasan	8	343	0	0
Fier	20	2951	21	0
Gjirokastrë	5	193	25	0
Korçë	25	1076	0	0
Kukës	1	103	0	0
Lezhe	15	2371	0	2371
Shkodër	18	1878	0	0
Tiranë	70	8683	3	1
Vlorë	24	2352	49	55
Total	231	24876	143	2427

Gjithashtu janë përgatitur disa udhëzime për zbatim nga inspektorët e punës në terren, në lidhje me mënyrën e inspektimit për efektivitetin e Këshillave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, Dokumentin e Vlerësimit të Riskut, mjekun e ndërmarrjes, përdorimin e paisjeve mbrojtëse individuale dhe kolektive, sinjalistikën në vendin e punës dhe elementë të tjerë të rëndësishëm të sigurisë dhe shëndetit në punë, me qëllim zbatimin sa më korrekt të këtij legjislacioni.

INSPEKTIMI I STANDARTEVE TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Gjatë muajit Shtator 2019, u realizuan inspektimet e planifikuara në **7 qendra jopublike**, të cilat ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror, rezidencial dhe komunitar në territorin e Bashkisë Korçë, Bashkisë Kolonjë dhe Bashkisë Maliq.

Realizimi progresiv për periudhën Janar – Shtator 2019

DISSHSH ka inspektuar dhe vlerësuar **gjithësej 101 qendra të ofrimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror**.

- Të inspektuara të programuara janë 82 qendra publike dhe jopublike që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror.**
- Të inspektuara e të paprogramuara janë 6.**
- Është vlerësuar situata e përgjithshme në 13 njësi shërbimi të përkujdesit shoqëror, shërbime të reja komunitare shumëdisiplinore, të krijuara nga Bashkitë vetë apo në partneritet. Është realizuar njohja e situatës së përgjithshme në 7 Bashki, nga 10 të planifikuara për vitin 2019.**

Vlerësim i përgjithshëm për qendrat e përkujdesit të inspektuara.

Qendrat e inspektuara, në muajin Shtator, janë:

1. **Qendra “Foleza”** e Fondacionit “Kisha Ungjillore Ersekë”, ofron shërbim të përkujdesit rezidencial për 9 fëmijë, dhe shërbim të përkujdesit ditor, (program: Passhkolle), për 10 fëmijë të komunitetit të Bashkisë Kolonjë;
2. Qendra e Shërbimeve Komunitare e Fondacionit “**Pishtarëmbajtësi**” Ersekë, ofron shërbim të përkujdesit në familje për 13 të moshuar dhe kampe verore për fëmijët e komunitetit të Bashkisë Kolonjë;
3. Qendra “**Vila Kenedi**” Korçë, ofron shërbime të përkujdesit rezidencial për të moshuar. Numri aktual i përfituesve është 28 të moshuar;
4. Qendra “**Shtëpia e Vajzave**”, qendër rezidenciale për vajza e Fondacionit Kenedi në Korçë. Numri aktual i vajzave të akomoduar është 7;
5. **Qendra komunitare** e përkujdesit ditor për fëmijë të komunitetit Ron dhe Egjyptian e Fondacionit Kenedi Korçë. Numri aktual i përfituesve është 13 fëmijë;
6. **Qendra komunitare** për të moshuarit e Fondacionit Kenedi Korçë, qendër e frekuentimit socializues të të moshuarve në qytetin e Korçës. Numri aktual i frekuentuesve ditore është 20 të moshuar.
7. **Qendra Rezidenciale Kenedi (Djem)**, qendër e përkujdesit rezidencial për fëmijë me vendodhje në Maliq. Numri aktual i fëmijëve të akomoduar është 5 djem.

Nga inspektimi rezultoi që të gjitha detyrat e lëna nga inspektimet e mëparshme, përsecilën qendër, janë realizuar. Veçojmë dhe njëkohësisht vlerësohet realizimi i detyrave për:

- plotësimin e stafit me figura profesionale, (punonjës social, psikolog), detyre kjo e lënë si për qendrat e Fondacionit Kenedi Korçë, ashtu edhe për qendrën rezidenciale për fëmijë të Fondacionin “Kisha Ungjillore Ersekë”;
- trajnimi i vazhdueshëm i stafit të qendrave nga Fondacioni Kenedi Korçë;
- rritja e numrit të moshuarve që nuk kanë mundësi pagese në Qendrën rezidenciale “Vila Kenedi” Korçë;

Në përfundim të inspektimit të 7 qendrave jopublike të përkujdesit shoqëror në Qarkun Korçë, vlerësohet kontributi i Fondacioneve, në mbështetje të fëmijëve, individëve, familjeve dhe në tërësi të komunitetit në nevojë.

Qendrat e përkujdesit rezidencial të inspektuara, vlerësohen për plotësimin e standarteve, veçanërisht Qendra “Vila Kenedi”, si edhe të gjitha shërbimet e tjera, vlerësohen për qasjen profesionale ndaj nevojave dhe respektimin e dinjitetit të përfituesve.